



## SUPPORTING EMPLOYMENT OF YOUNG PEOPLE



This project is funded by the European Union

Agjencia e Punësimit të Republikës së Maqedonisë (APRM), në suaza të projektit “Mbështetja për punësimin e të rinjve”, të financuar nga ana e Programit Operativ për “Zhvillimin e burimeve njerëzore 2007-2013” Komponenti IPA IV), por në bazë të Planit Operativ të shërbimeve në tregun e punës dhe programeve e masave aktive të punësimit për vitin 2017, bën:

### Shpallje të hapur publike Për personat e rinj dhe papunë për pjesëmarrje në masën „Prakticiteti”

U bëhet thirrje personave të evidentuar si të papunë (kërkuesve aktiv të punës) deri në moshën 29 vjet, të cilët janë të interesuar për t’u përfshirë në masën “Prakticiteti” me mundësi për të fituar njohuri dhe aftësi praktike gjatë një periudhe prej 3 (tre) muaj.

Personat e papunë duhet t’i plotësojnë kriteret siç vijojnë:

- Të jenë të regjistruar si kërkues aktiv të punës në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë;
- Të kenë të kryer së paku shkollimin e mesëm në përputhje me nevojat e tregut të punës;
- Të jenë të moshës deri në 29 vjet;
- Pa përvojë pune paraprake bazuar në arsimimin e tyre.

Kandidatët e zgjedhur do të kalojnë programin tremujorë të praktikitetit. Stërvitja e personave të papunë do të mbahet në lokalet afariste të punëdhënësve, në përputhje me programin e stërvitjes të propozuar nga ana e punëdhënësve.

Për secilin kandidat që do të zgjidhet dhe që do të përfshihet në programin e praktikitetit, është paraparë një pagesë me të holla (shpenzime për ushqim dhe udhëtim) në një shumë prej 5.043,00 denarë në muaj për secilin praktikant (duke përfshirë sigurimin në rast fatkeqësie gjatë punës dhe sëmundjes profesionale në një shumë prej 658,00 denarë dhe tatimin personal për të ardhurat prej 560,00 denarë) nga ana e projektit të financuar nga BE.

Kandidatët e përshtatshëm që janë të interesuar, do të zgjidhen nga ana komisionit të evaluimit sipas nevojave dhe kërkesave të punëdhënësve. Të gjithë kandidatët e zgjedhur do të informohen për rezultatin e selektimit.

Personat e papunë që janë të interesuar për këtë shpallje, mund t’i dorëzojnë fletëparaqitjet në vazhdimësi gjatë tërë vitit brenda orarit të punës 8:30 – 16:30, çdo ditë pune duke filluar prej 02.02.2017.

Para nënshkrimit të marrëveshjes, punëdhënësit do të jenë përgjegjës për nënshkrimin e deklaratës me të cilën vërtetohet se nuk ekziston konflikt interesi për sa u përket personave që do të marrin pjesë në programin e praktikitetit.

Për informata më të hollësishme, ju lutemi vizitoni klubet e punës në suaza të qendrave të punësimit në gjithë shtetin, si dhe ueb faqet siç vijojnë:

- Agjencia e Punësimit: [www.avrm.gov.mk](http://www.avrm.gov.mk);
- Ministria e Punës dhe Politikës Sociale: [www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk);

